

Fuqizohet flota e Urgjencës Kombëtare



Tetë autoambulanca të reja, me pajisje të fjalës së fundit të teknologjisë, i janë shtuar flotës së Urgjencës Kombëtare. Në katër vitet e fundit kjo flotë është zgjeruar me 110 autoambulanca të reja, për një përgjigje më të mirë dhe më të shpejtë në territor. Investimet në flotën e mjeteve motorrike të urgjencës para-spitalore do të vijojnë edhe në vitin 2023.



NJËSI TË LËVIZSHME PËR KUJDESIN DENTAR TË FËMIJËVE

Dy njësi të reja të lëvizshme të dentistrisë, me pajisje të fjalës së fundit të teknologjisë janë vendosur në dispozicion të zonave rurale, për të rritur aksesin në shërbimin dentar për nxënësit e shkollave. Përgjatë viti 2021-2022 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka investuar në strukturat e kujdesit të arsimit parauniversitar me 19 njësi të reja dentare, ku 10 prej tyre u instaluan në Tiranë dhe të tjerat në tre qarqe, Elbasan, Durrës dhe Shkodër. Edhe këtë vit, MSHMS do të vijojë investimet në shkolla për të zgjeruar bazën e njësive dentare me unite të reja në të gjithë Shqipërinë.



PROJEKTI I TRANSFORMIMIT TË SPITALIT RAJONAL LEZHË

Pas ndërtimit të Maternitetit të ri të Lezhës, investimi në godinën qendrore të Spitalit Rajonal Lezhë përmbyll ciklin e investimeve në këtë spital. Investimi do të përfshijë godinën qendrore të spitalit me sipërfaqje ndërtimi rreth 4.000 m2, ku përfshihen të gjitha shërbimet të plotësuara me shtretër, reanimacioni, urgjencat pediatrike dhe ato për të rritur, terapia intensive, pediatria, kirurgjia, me një kapacitet prej 117 shtretëri.



PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR NËNAT ME SHUMË FËMIJË

Ka nisur programi i mbështetjes për nënat e papuna me tre apo më shumë fëmijë të mitur, të cilat përfitojnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke i'u njohur si punë e paguar 5 vitet e para të rritjes së fëmijës. Nga ky program vetëm për muajin Janar kanë përfituar 5,210 nëna të papuna me më shumë se tre fëmijë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu u ndal në qarqet e Shkodrës dhe të Korçës, ku bashkëbisedoi me nënat përfutuese të kësaj politike të re të qeverisë, e cila vjen në vazhdim të politikave sociale që mbështesin gratë dhe shtresat në nevojë.

FUQIZOHET FLOTA E IMAZHERISË NË SPITALIN E KORÇËS

Spitali i Korçës është fuqizuar në shërbimin e imazherisë me rezonancë, skaner dhe aparatë për matjen e denismetrisë kockore (DEXA), duke plotësuar kështu nevojat për të ofruar shërbime shëndetësore pranë vendbanimit për banorët e këtij qaraku. Flota e pajisjeve mjekësore ka sjellë rishtazi në strukturat spitalore katër skanera të rinj të teknologjisë së fundit, një angiograf të ri, 18 grafi të reja dhe 4 ECHO.

